

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Lidhur me grevën e Sindikatave, i dhashë udhëzimet kryeministrit Fatos Nano, por ne s'duhet ta ndërpr esim veprimtarinë tonë komuniste..."/ Zbulohet raporti i Ramiz Alisë, në mbledhjen e Byrosë, 11 prill '91
ADRESA	https://prapaskena.com/2026/08/21/lidhur-me-greven-e-sindikatave-i-dhashe-udhezimet-krye-ministrit-fatos-nano-por-ne-sduhet-ta-nderpresim-veprimtarine-tone-komuniste-zbulohet-ra-porti-i-ramiz-alise/
BURIMI	prapaskena.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 06:49:12 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	20 gusht 2026, 22:00:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 20 gusht 2026, 21:59:00 UTC → 20 gusht 2026, 22:01:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të g abojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	08f16dfcb4aa0bb9bcb2e2d7cfcf833666fc75b86451f6bd2a2307d36b56be00
TEKSTI	95a8b511902f74f2bfb28546c44dbf16f211a0862f9ed631433d0893d0999c1d
PAMJA	d5e7ea6f3def69fb17e12130f883bbf14f86fa0cc9635e26cb37f7b514b06d31

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	21de7e677711efa4853b9d9ed70168dff08712c20aceb2c089cc2739e69502d2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3cbdf23231ddbe1301737130b50cb215bb8d138f7bee92a7c7c6c6c8c9c45afe
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/21de7e677711efa4853b9d9ed70168dff08712c20aceb2c089cc2739e69502d2

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Lidhur me grevën e Sindikatave, i dhashë udhëzimet kryeministrit Fatos Nano, por ne s’duhet ta ndërpresim veprimtarinë tonë komuniste...”/ Zbulohet raporti i Ramiz Alisë, në mbledhjen e Byrosë, 11 prill ‘91

Kryesore

Publikuar: 21/08/2026

f X



Nga Dashnor Kaloçi

Kur nuk kishin kaluar veçse dhjetë ditë nga mbajtja e zgjedhjeve të para pluraliste të 31 marsit dhe dy forcat kryesore politike, Partia e Punës dhe Partia Demokratike, së bashku me aletatët e tyre, të dala nga ato zgjedhje, ishin në prag të hapjes së Kuvendit të parë Popullor pluralist, Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, me në krye sekretarin e përgjithshëm të saj Ramiz Alia, (njëkohësisht mbante edhe postin e kryetarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë), më datën 11 prill 1991, zhvilloi një mbledhje të gjatë, ku përveç ngjarjeve të 2 prillit në qytetin e Shkodrës, që ishte dhe pika e parë e rendit të ditës, diskutoi edhe për problematikat që po shfaqeshin me çeljen e seancës së parë të Parlamentit të parë pluralist, gjë e cila ishte një ngjarje tejet e veçantë, pasi ajo gjë ndodhte për herë të parë pas 45 vitesh të sundimit të regjimit komunist të Enver Hoxhës dhe pasardhësit të tij Ramiz Alia.

Siç do të shohim dhe nga proces-verbali në fjalë mbi zhvillimin e kësaj mbledhje të Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH-së, aty janë marrë në shqyrtim dhe janë diskutuar disa nga problemet më radikale të dramës politike që po kalonte Shqipëria në pranverën e vitit 1991, ku zbulohen qartë edhe prapaskenat e

Me të lexuarat

Kush është

Behajdin Allaqi, njeriu që Haga vendosi në qendër të dënimit të



Doktorit dhe përkrahës të Rruga e Kosovareve dhe biznes shit-blerje pronash,



Si pasqyroi në video pornografike në një bisedë me shoqet, si u zbulua abuzimi i 12-vjeçares



Historia e gjeneralit kroat të Bosnjes që vrau veten me helm në sallën e gjyqimit në



Udhëzimet e me naftë/ Shehu kërkon llogari për gjenocidin serb, Haga rikthen akuzat e ...



pushtetit komunist në fuqi me në krye Ramiz Alinë, që ishte në grahmat e fundit dhe po përballej me rënien e tij të pashmangshme, por me ngjarjet e përgjakshme siç ishin ato të 2 prillit në qytetin e Shkodrës, si dhe me sfidat e panjohura të pluralizmit politik.

Sa më sipër, ky dokument arkivor hedh dritë dhe ndriçon tre çështje kyçe që po trazonin kupolën drejtuese të vendit në ato ditë kritike: ku pjesa më interesante është ajo që lidhet me “arkitekturën” politike që po projektonte PPSH-ja, për Kuvendin e Ri, ku kishte 54 agronomë e 35 mjekë. Diskutimet për ndarjen e komisioneve parlamentare, studimi i përvojës bullgare, propozimi i figurave të reja si Kastriot Islami në krye të parlamentit, si dhe përgatitjet për përballjen me opozitën e re (Partinë Demokratike), zbulojnë qartë të gjitha përpjekjet dhe demarshet që po bënte PPSH-ja ende në fuqi, e cila po përpiqej të ruante kontrollin e pushtetit përmes procedurave kushtetuese dhe diplomacisë parlamentare.

Dokumenti në fjalë publikohet i plotë duke ruajtur të gjithë dinamikën e fjalimeve, terminologjinë e kohës dhe ndërhyrjet e anëtarëve të Byrosë Politike, duke filluar nga kreu i saj, Ramiz Alia, e me radhë Xhelil Gjoni, Adil Çarçani, Hekuran Isai, Spiro Dede e të tjerë. Po kështu me mjaft interes janë edhe diskutimet e krerëve më të lartë të PPSH-së, jo vetëm ndaj emrave të forcës së tyre politike që ata po përzgjidhnin në krye të qeverisë, instuticioneve kushtetuese apo grupit dhe komisioneve parlamentare, si; Fats Nano, Haxhi Lleshi, Llambi Gegprifti, Ismail Lleshi, Petro Dode, Fehmi Avdiu, Çun Jonuzi, Ajli Alushani, Kleanthi Koçi, Pëllumb Kapo, Lush Përpali, Tahir Elezi, Lefter Xhuvëli, Bilbil Jaupi, Lutfi Dautllari, Fatmir Zaloshnja, etj., por edhe me opozitën e kryesuar nga Partia Demokratike, ku ata flasin e diskutojnë me emra konkret, si p.sh. Aleksandër Meksi, Genc Ruli, Emin Myslu, Dhimitër Anagnosti, Petraq Kolevica etj.

Për më shumë rreth kësaj etj., na njeh dokumenti në fjalë i nxjerrë së-fundmi nga Arkivi Qendror i Shtetit Tiranë, (fondi i ish-Komitetit Qendror të PPSH-së), që publikohet për herë të parë dhe me faksimilet përkatëse nga Memorie.al, i cili në një farë mënyre tregon qartë të gjitha prapaskenat e tranzicionit shqiptar të asaj periudhe kohe, që padyshim përbëjnë disa nga ngjarjet më të rëndësishmet e Shqipërisë, që nga krijimi i shtetit, në 28 nëntorin e vitit 1912.

PROCES-VERBAL I MBLEDHJES SË BYROSË POLITIKE I MBAJTUR NË MBLEDHJEN E BYROSË POLITIKE TË KOMITETIT QENDROR TË PARTISË

Mbi ngjarjet e Shkodrës më 2 prill 1991

Mbi qëndrimin ndaj kërkesave të sindikatave dhe organizatave e shoqatave që krijohen.

Problemet që dalin për hapjen e Kuvendit të ri pluralist.

(Rendi i ditës nuk ishte shpërndarë më parë)

Mungojnë shokët: Pali Miska, Vangjel Çërava, Xhemal Dymylja.

SHOKU RAMIZ ALIA: Mendova të bënim këtë mbledhje të Byrosë për të diskutuar mbi gjendjen e këtyre ditëve dhe ç'detyra kemi përpara. Gjatë këtyre kohëve, siç jeni të tërë në dijeni, ndodhën ngjarjet e Shkodrës, ku u vranë tre veta, vdiq dhe një i katërt nga plagët që mori atë ditë; u dogj komiteti i Partisë i Punës të Shkodrës dhe, përgjithësisht, atje është krijuar një gjendje mjaft e vështirë.

Këto janë, sipas të dhënave që kemi deri tani, të cilat janë tepër kontradiktore, tepër të paplota, sepse hetuesia po punon, por me një stil shumë të ngathët. Siç duket, këto ngjarje ishin të provokuara. Aty, siç duket, ishte përgatitur me qëllim që të provokonin një incident, të cilin kundërshtarët tanë ta përdornin për të diskredituar partinë tonë. Dhe e dyta, për të krijuar një gjendje të nderë në Shkodër, duke synuar që ta konsiderojnë dhe Shkodrën si një bazë të veprimtarisë së tyre.

Ngjarjet kanë filluar në datën 1 prill, një ditë pas zgjedhjeve, kur turma njerëzish kanë dalë nëpër rrugët e qytetit të Shkodrës pa lejen e policisë, me parulla të ndryshme, sharje kundër partisë sonë, kundër zgjedhjeve, gjoja për falsifikim në zgjedhje etj. Kanë demonstruar rreth dy orë, pastaj në orët e vona të natës janë shpërndarë. Forcat e rendit nuk kanë kundërvepruar.

Ditën e dytë, më 2 prill, ngjarjet janë zhvilluar më ndryshe. Prapë janë bërë grumbullime të paligjshme, sidomos nga nxënës të dy shkollave të mesme të qytetit të Shkodrës, me të cilët janë bashkuar dhe masa të tjera njerëzish. Kanë ndjekur po të njëjtën taktikë: parulla, sharje, fyerje, britma etj. Në këtë rast ka ndërhyrë policia për t'i shpërndarë me mjete force, pa përdorur armët. Por më vonë, kur masa ka filluar të qëllojë me gurë kundër policisë, kur është afruar afër komitetit të Partisë, policia ka përdorur dhe armët, ka qëlluar.

Në këto veprime, dikush para, dikush më pas, kanë mbetur të vrarë tre veta dhe janë plagosur një numër i madh njerëzish. Pas këtij veprimi, masa ka sulmuar drejt Komitetit të Partisë, policia është futur në Komitetin e Partisë, pastaj me një urdhër është larguar prej andej, kurse turma ka hyrë në komitet, i ka vënë flakën, ka hyrë kat më kat, ka nxjerrë ç'ka dashur për të nxjerrë, ka djegur çka dashur për të djegur, ka prishur çka dashur për të prishur.

Xhemal Dymylja ka dalë nga prapa dhe mur më mur ka shpëtuar, kurse të gjithë të tjerët kanë dalë nga dera e përparme. Turma nuk i ka ngacmuar kur kanë dalë Bukurie Cungu, Adem Golemi e punonjës të tjerë të aparatit. Mbasi kanë kaluar një pjesë rruge, i janë sulur Gjeri Grabovës, e kanë rrabur e kërdisur keq fort

janë bërë gjergj, shqiptarë, e kanë marrë e kanë marrë, pastaj dikush e ka marrë, e ka futur në shtëpi të vet dhe nga një shtëpi në tjetrën e shpëtuan.

Natyrisht, e tërë kjo histori krijoi një gjendje shumë të acaruar në Shkodër, kaq sa në varrimin e atyre të treve thuhet se kanë marrë pjesë dhjetra-mijëra njerëz të revoltuar për atë që ndodhi. Juve e keni parë dhe në axhanset që kjo ngjarje në botë bëri një efekt shumë të keq. Versioni i forcave të opozitës, sigurisht ishte sipas oreksit të saj, sikur tërë kjo gjurullldi filloi sepse u vra një nga drejtuesit e Partisë Demokratike nga dikush nga brenda i komitetit të Partisë, se plumbi i ka rënë në kurriz dhe plaga është përpara etj., etj. të cilat natyrisht nuk mundet t'i vërtetojë veçse hetuesia.

Hetuesia është duke bërë punët e veta, por, e thashë, mjaft të ngadalta, megjithëse duhet thënë se janë mjaft të vështira sepse ai thotë njëri nuk thotë tjetri, autopsy kufomës nuk i është bërë, se nuk kanë lejuar, njerëzit nuk flasin, vetëm thonë që "kam parë një njeri me flokë, tjetri një njeri pa flokë". Natyrisht, ka vështirësitë e veta dhe hetuesia.

Sidoqoftë ky është bërë tani një nga problemet më të vështira të kohës. Mua më erdhën përfaqësues të Sindikatave të Pavarura të Shkodrës dhe të qendrës, m'i shtruan këto çështje, siç më kanë ardhur dhe nga Partia Demokratike, kanë dërguar dhe protesta ku kërkojnë të hidhet dritë mbi këtë çështje, të gjenden shkaktarët e të tjera; Pastaj brenda në këtë histori ka sa të doni fantazira, sikur u zunë në komitetin e Partisë (së Punës) armë, mitraloza, frigoriferë me gjellë dhe rezervë ushqimore, që, si të thuash, zbukurojnë të tërë këtë histori.

Kjo ngjarje duhet sqaruar sipas të dhënave që do të kemi nga hetuesia. Deri sot është tepër e vështirë të sqarohet, se si thotë njëri nuk thotë tjetri dhe hetuesia akoma nuk ka arritur konkluzionet përfundimtare mbi këtë çështje, e cila tani është bërë, si të thuash, mollë sherri, se është e qartë që kërkohej dhe nga opozita për të krijuar precedencë për të acaruar situatat dhe për të krijuar probleme për të ardhmen. Në fakt e nxorën kokën dhe dje me dy evenimente.

Së pari, organizata e Sindikatave të Pavarura ka bërë një farë shkrese për Kryeministrinë, që ia dërgon për dijeni dhe Presidiumit të Kuvendit Popullor, në të cilën shtron 17 kërkesa, një ndër të cilat ku kërkon të shtohen 50 për qind pagat e të gjithë kategorive të njerëzve. Vazhdon duke thënë që më 14 prill të jepet konkluzioni për ngjarjet e Shkodrës, për të cilat duhet të mbajë një qëndrim të përcaktuar radioja, televizioni, shtypi, të bëhet gjyqi i hapura për shkaktarët e kësaj ngjarjeje e të tjera, se ndryshe kjo organizatë do të përdorë të tëra mjetet demokratike, duke përfshirë dhe grevën. Me një fjalë të imponojë mendimet e veta.

Evenimenti i dytë që nxori koken ishte në një takim që patën Spiro, Ismail Lleshi dhe Fehmi Abdiu, me Partinë Demokratike lidhur me përgatitjet për sesionin e ardhshëm të Kuvendit Popullor. Në këtë takim, mbasi biseduam mbi procedurën dhe masat që duhen marrë, me qëllim që të vemi në Kuvend bashkërisht për të mos patur diskutime të kota lidhur me procedurat si, kush do ta kryesojë mbledhjen, formula e betimit e të tjera, për të gjitha ranë dakord, por thanë që ka mundësi që ata të mos vijnë në Kuvend, në qoftë se nuk jepen konkluzionet për ngjarjen e Shkodrës.

Shokët u thanë që nër ngjarjen e Shkodrës ka organizma të